



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:137733

Datë: 21.08.2024

Numri i dokumentit: 06072500

AC.nr.6236/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin gjyqësor të përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Burim Shala, anëtarë të kolegjit në çështjen juridike kontestimore të paditësit-kundëripadituri M. L. rr. ..., Ferizaj, kundër të paditurit- kundërpaditësit A. P, rr... Shkup -Republika me Maqedonisë të cilin e përfaqëson av. Burhan Qosa, nga Ferizaj, baza e kontestit vërtetimin e pronësisë, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil , C.nr.620/11, të datës 15.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 15.08.2024 mori këtë :

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e autorizuarit të paditurit-kundër paditësit A. P..., PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil , C.nr.620/2011, të datës 15.07.2021, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin e ankimuar në pikën një të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit – kundër të paditurit M. L., nga F... rr. ... nr..., si e bazuar. Në pikën dy të dispozitivit vërtetohet se paditësi- kundër i padituri është pronar i njësisë ngastrës kadastrale nr. ..., vendi i quajtur ..., lloji i njësisë parcelë- me sipërfaqe të përgjithshme prej ... m², ZK Ferizaj. Në pikën tre të dispozitivit refuzohet kundërpadia e të paditurit-kundërpaditësit A. P. Rr.. Shkup -Republika me Maqedonisë, e ushtruar kundër të paditurit – kundërpaditësit M. L., nga Ferizaj rr. ..., për vërtetim pronësie, si e pabazuar. Ndërsa në pikën katër të dispozitivit ka detyruar të paditurit- kundërpaditësin që paditësit- kundër të paditurit ti njohin të drejtën e pronësisë dhe ta lejojnë regjistrimin e të njëjtës në regjistrat e kadastrit në drejtorinë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronësi në Ferizaj, në afat prej 15 dite, nga dita e

plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Ndërsa në pikën pesë të dispozitivit është caktuar masa e sigurisë me datë ..., mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, i autorizuari i të paditurit-kundër paditësit A. P., me kohë kanë paraqitur ankesë, për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, si gjykatë e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 195 pika (e) lidhur kjo me nenin 201 të LPK-së, me AKTGJYKIM të APROVOJ ankesën e të paditurit kundërpaditësit A. P., Rr... nr..., në Shkup Republika e Maqedonisë së Veriut, dhe ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë, duke bërë ashtu që, të: REFUZOHET në tërësi SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit-kundër-të paditurit M. L., nga Ferizaj Rr. ... nr.... APROVOHET në tërësi SI E BAZUAR kërkesa e kundërpadisë së të padituritkundër-paditësit A. P., Rr..., nr..., në Shkup Republika e Maqedonisë së Veriut, VËRTETOHET SE, i padituri-kundërpaditësi është pronar i paluajtshmerisë me numër të njësisë kadastrale ..., vendi i quajtur "...me sipërfaqe prej ...m2 ZK-Ferizaj. OBLIGOHET paditësi-kundëripadituri M. L., nga Ferizaj, që të paditurit-kundër-paditësit A. P., t'ia njoh të drejtën e pronësisë mbi këtë pronë dhe ta lejoj regjistrimin e saj në regjistrat kadastral në emër të të padituritkundër-paditësit, në afat prej 15 dite pas pranimit të plotfuqishmërisë aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim do ti shërbej të paditurit-kundërpaditësit A. P., për të bërë regjistrimin e pronës në emrin e tij në regjistrat kadastral ZKK Ferizaj. OBLIGOHET paditësi kundëripadituri M. L., nga Ferizaj, që të paditurit-kundërpaditësit A. P., të ia kompensojnë të gjitha shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej ... euro, konform numrit tarifar 6 dhe 7 të tarifës së OAK-së, dhe atë: shumë prej ..., euro në emër të shtatë (7) seancave të mbajtura në këtë çështje, për secilën veç e veç nga ... euro, si dhe shumë prej ... euro, në emër të përpilimit të 6 parashtrësive, si dhe shumë prej ... euro në emër të përpilimit të kësaj anekse dhe 30 euro në emër të taksës gjyqësore për këtë ankesë, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

Ankesa e të paditurit-kundër paditësit, është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja M. L., nga Ferizaj, më datë ..., ka paraqitur padi, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, kundër të paditurve A. P. nga F...

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën për shqyrtim kryesor dhe ka administruar provat si: përgjigja në padi e dt.24.12.2015, ekspertizën e gjeodezis e dt 17.03.2016, certifikatën e pronësisë në emër të R. P., raportin e njësisë kadastrale dhe kopja e planit, aktgjykimin C.nr.620/11 dt. 15.12.2016, propozimin për përsëritjen e procedurës dt. 09.10.2017, aktvendimin LRP.nr.10554/17 ref nr.3891/17 propozim për masën e sigurisë dt.01.11.2017, shkresat në gjuhën

serbe, certifikata e vdekjes nga republika e Maqedonisë për R. P, shkresat nga gjykata e apelit CN.nr.116/17, aktvendimin C.nr.620/11 dt 30.01.2019, përgjigjen me shkrim dt.06.02.2019, kundërshtimin ndaj propozimit për përsëritjen e procedurës dt.12.02.2019, propozimin për përsëritjen e procedurës dt.11.02.2019, parashtresën e dt.14.01.2020, aktgjykimin K.nr 237/61 dt. 09.12.1961, deklaratën e noterizuar me nr LRP.nr ..., deklaratën e noterizuar me nr LRP.nr....., deklaratën e noterizuar me nr LRP.nr....., deklaratën e noterizuar me nr LRP.nr..., certifikatën e vdekjes nga republika e Maqedonis për R. P., H. P., aktvendimin nga gjykata e apelit AC.nr.4746/18 dt.17.09.2019, aktvendimin C.nr.620/11 dt. 21.01.2020, propozimin për përsëritjen e procedurës 21.01.2020, aktvendimin nga gjykata e apelit CN.nr.116/17 dt.15.05.2020, parashtresën nga paditësi – kundër i padituri, përgjigje në padi dhe kundër padi dt.05.02.2020, kontratën e shitblerjes dt. 25.12.1946 dhe certifikatën e pronësisë nr. 3485.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar gjendjen faktike sa i përket faktit se ka aprovuar padinë e paditësit-kundërtëpadituri si të bazuar, e ka vërtetuar sidomos nga shfrytëzimi me mirëbesim i parcelave kontestuese nga paditësi-kundëripadituri, pasi paditësi – kundëripadituri ka arritur të provoj para gjykatës së atë parcelë e ka blerë në vitin 1981, dhe që nga ajo kohë i njëjti ka hyrë në posedim të palujtshmërisë menjëherë, dhe që nga ajo e ka në posedim dhe shfrytëzim dhe se askush nuk e ka penguar që të shfrytëzoj të njëjtën. Fakti se paditësi ka deklaruar se e ka blerë pronën në vitin 1981 ndërsa nga provat e administruara u vërtetua fakti se R. P., ka vdekur në vitin 1973, gjykata e ka pasur parasysh por paditësi ka deklaruar se këtë pronë e ka blerë nga një grua me emrin R. P., por pasi nuk kanë përpiluar kontratë nuk mund ta vërtetojmë identitetin e shitëses, mirëpo për gjykatën nuk ka qenë kontestues mirëbesimi i paditësit, dhe hyrja e tij në posedim të asaj prone me mirëbesim, pasi i njëjti që nga fillimi ka deklaruar njëjtë se e ka blerë pronën në vitin 1981, ka paguar çmimin dhe ka hyrë në posedim dhe asnjëherë askush dhe asgjë nuk e ka penguar në shfrytëzimin e qetë dhe të papenguar të asaj ngastre.

Me përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, nuk pajtohet Gjykata e Apelit pasi që aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parag.1 , neni 182 par.2 pika n), neni 183 dhe neni 184 të LPK-së, gjendja faktike është konstatuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë dhe si rezultat i kësaj edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht për këtë edhe aktgjykimi është dashur të priset dhe çështja të kthehet në ri vendosje.

Aktgjykimi i ankimuar përmban të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parag.2 pika n). Kjo për faktin se aktgjykimi nuk mund të ekzaminohet, e sidomos dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm dhe kontradiktor me arsyet e aktgjykimit. Deri te këto shkelje ka ardhur si rezultat i faktit se në dispozitiv të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë nuk e ka përcaktuar se sipas cilës bazë juridike paditësi është pronar i ngastrës kadastrale nr....., vendi L..., në sip.prej ... m2 . Ndërkaq në arsyetim gjykata e shkallës së parë ka lënë dilema apo kontradikta të tilla të cilat e bëjnë të pa kuptueshëm aktgjykimin në tërësi.

Nuk është përcaktuar saktë se mbi cilën bazë juridike e ka fituar paditësi të drejtën e pronësisë në ngastrën kontestuese.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të bazuara pretendimet ankimore të , paditurit-kundër paditësit për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk e ka konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Kjo për faktin se kanë mbetur pa u sqaruar faktet relevante të cilat kanë ndikim për zgjidhjen e drejtë të çështjes së shtruar nga paditësit me padi. Nuk është paraqitur një historia i plotë për ngastrën kontestuese .

Mbi bazë të gjendjes faktike të konstatuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale.

Udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri vendosje ti marr parasysht vërejtjet e lartë cekura ta përpiloj aktgjykimin në pajtim me nenin 160 parag.3 dhe 4 të LPK-së. Dispozitivi duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm duke përcaktuar edhe bazën sipas së cilës paditësi-kundëripadituri e ka fituar të drejtën e pronësisë në ngastrën kontestuese. Më pastaj të eliminoj kontradiktat duke përcaktuar vetëm një bazë të fitimit të së drejtës së pronësisë. Të jap arsyetim të duhur për faktet vendimtare. E sidomos për historiatin e ngastrës kontestuese. Me rastin e rishqyrtimit të çështjes gjykata e shkallës së parë të dalë në vendin e ngjarjes së bashku me ekspertin e gjeodezisë, pas këqyrjes së vendit të ngjarjes ti caktohen detyrat e sakta ekspertit gjeodetë në mënyre që ai të jap një historiat të detajuar dhe të plotë për ngastrën kadastrale kontestuese përkatësisht për bartjet të cilat duhen bërë. Të bëjë dëgjimin e palëve ndërgjyqësore në cilësi të palës si dhe provat tjera të cilat do të propozojnë ndërgjyqësit. Ti vlerësoj, drejtë provat sidomos deklaratat e dëshmitarëve duke treguar edhe arsyen se si ka vlerësuar këto deklaratat e më pastaj të vendos për kërkesëpadinë e paditësit në bazë të ligjit.

Nga të cekurat më lartë e duke u mbështetur dispozitën e nenit 194, 195 paragrafi 1 pika c) të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË

AC.nr.6236/2021 më datë 15.08.2024

Kryetari i Kolegjit – gjyqtari
Nehat Idrizi d.v.